



SYLLABUS I LËNDËS “E Drejta e Punës dhe e Drejta Sociale”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta e Punës dhe e Drejta Sociale
Programi:	Juridik I pergjithshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	IV
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	
Koha / lokacioni:	Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla), si dhe detaje të tjera do te caktohen në bashkëpunim me Fakultetin
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. dr. Safet Krasniqi
Të dhënat kontaktuese:	e-mail: safet.krasniqi@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	E drejta e punës si degë e sistemit pozitiv-juridik përfshinë normat shtetërore, kontratat kolektive dhe dispozitat autonome që i referohen marrëdhënieve të punës në ndërmarrje, institucione, tek punëdhënësit dhe subjekte të tjera. Pra, e drejta pozitive juridike e punës, përfshinë tërësinë e parimeve juridike dhe tërësinë e normave juridike në bazë të cilave rregullohen marrëdhënet e punës.
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është njoftimi i juristëve të ardhshëm lidhur me të drejtat dhe obligimet e subjekteve të marrëdhënieve të punës (punëdhënës – punëmarrës) që burojnë nga Konventat Ndërkombëtare, Ligji i Punës i Republikës së Kosovës. Kjo synohet të arrihet përmes ligjeratave me studentë, diskutimeve, shtjellimit të rasteve praktike dhe formave të tjera të cilat i konsiderojmë të domosdoshme për mësimdhënie.
Rezultatet e të nxënit:	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none">■ Të aftësohen për interpretimin e dispozitave juridike nga kjo fushë;■ Të njoftohen për të drejtat dhe obligimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit;



	<ul style="list-style-type: none"> ■ Të jenë të gatshëm që t'i përdorin njohuritë teorike dhe praktike me qëllim të hartimit të legjislacionit nga kjo fushë. 		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	05	10
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgatitja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	6	2	15
Projektet, prezantimet ,etj	3	4	12
Totali			149.5 orë (6 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> ■ Ligjerata interaktive; ■ Diskutime; ■ Prezantime të punimeve seminarike; ■ Ushtrime nga lëmia e të drejtës së punës. 		
Metodologjia e vlerësimit:	<p>Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime 10%</p> <p>Aktiviteti gjatë semestrit 10%</p> <p>Punimi Seminarik dhe mbrojtja e punimit 10%</p> <p>Vlerësimi intermediar: 20%</p> <p>Provimi final: 50%</p> <p>Total 100%</p>		
Literatura			
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> ■ Avdullah Robaj, E drejta e punës, Pejë, 2017; 		

	<ul style="list-style-type: none"> ■ Hava Bujupaj-Ismajli, E drejta e punës, Prishtinë, 2014; ■ Gëzime Starova, E drejta e punës, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2004; ■ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008; ■ Kuvendi i Kosovës, Ligji i PUNËS i Republikës së Kosovës, 2010; ■ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës; 2010.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> ■ Kudret Çela, E drejta e punës, Tiranë, 2013; ■ Konventat e ONP-së; ■ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Sigurinë në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Ambientit të Punës, 2007; ■ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Inspektoratin e Punës, 2008; ■ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Dhënien e Lejes për Punë dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, 2009; ■ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Greva, 2010, 2012;
	<ul style="list-style-type: none"> ■ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, 2008; ■ Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, 2014.

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Hyrje Përshkrimi i programit	



<i>Java e dytë:</i>	Nocioni, objekti dhe subjektet e së drejtës së punës	
<i>Java e tretë:</i>	Burimet e së drejtës së punës	
<i>Java e katërt:</i>	Parimet e së drejtës së punës Raporti i së drejtës së punës me degët tjera të së drejtës	
<i>Java e pestë:</i>	Marrëdhëniet individuale të punës, kontrata Individuale e punës, llojet e kontratave të punës	
<i>Java e gjashtë:</i>	Detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit, Kushtet e punës, llojet e pushimit	
<i>Java e shtatë:</i>	Paga, shpërblimet dhe përfitimet tjera nga puna	
<i>Java e tetë:</i>	Përgjegjësia disiplinore në punë, mbrojtja juridike e të drejtave nga marrëdhënia e punës	
<i>Java e nëntë:</i>	Vlerësimi intermediar	
<i>Java e dhjetë:</i>	Përfundimi i marrëdhënieve juridike të punës	
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Marrëdhëniet kolektive të punës, e drejta sindikale, e drejta kolektive e punës	
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Konflikti kolektiv i punës	
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	E drejta e veprimit kolektiv të punëmarrësve dhe e punëdhënësve, grevat dhe lock-out-i	
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Organizata ndërkombëtare e punës (onp)	
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Rikapitulim dhe përgatitje për provim final	
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<p>Studentët janë të obliguar që t'i përmbahen kriterëve të përcaktuara në syllabusin e lëndës dhe përgatitjen e provimit bazuar në literaturën bazë. Pjesëmarrja aktive / debati i studentëve në ligjeratë do të vlerësohet. Studentët obligohen që t'i përmbahen politikave akademike dhe rregullave të</p>		



mirësjelljes, si:

- Vijimi i rregullt në ligjeratë;
- Respektimi i orarit në ligjërata dhe ushtrime;
- Mos lëshimi i sallës gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve;
- Ruajtja e integritetit akademik;
- Ruajtja e disiplinës gjatë procesit mësimor;
- Mospërdorimi i telefonave celular gjatë ligjëratave (përveç në raste urgjente);
- Respektimi i rregullave gjatë testeve dhe provimit (moskopjimi, mos bisedimi me kolegë, etj.).